




Ndihma në mësim & ndihma në detyra të shtëpisë

"Një fëmijë, një mësues, një stilolaps dhe një libër mund të ndryshojnë botën". (Malala Yousafzai)



Ndihma në mësim dhe ndihma në detyra të shtëpisë“ është një program i paraparë për nxënës të shkollës fillore (VS, NMS dhe gjimnaze të ultë) gjithashtu do të mbahet edhe në Institucionet Arsimore në të cilat këtë program e parashohin.

Nxënësit do të marrin ndihma mësimore në lëndët e matematikës, gjermanishtës dhe anglishtës, me detyrat e tyre të shtëpisë, si dhe do të mësojnë që të përgatiten për provime. Ata do të mësojnë ashtu që të "mësojnë se si duhet të mësojnë", duke marrë parasysh planet e tyre individuale të ndihmës në të mësuarit, me anë të udhëzimeve të cilat i dedikohen mësimit, që të orientohen gjithashtu drejt botës së jetës dhe historisë si dhe kërkesave të nxënësve.

Qëllimet

- Zgjerimi i mundësive për një përfundim pozitiv të shkollës së detyrueshme
- Forcimi i pavarësisë dhe aftësive të nxënësve pjesëmarrës
- Përmirësimi i integritetit në shkollë
- Forcimi i vetëvlerësimit emocional të nxënësve pjesëmarrës
- Forcimi i aftësive sociale dhe ndërkulturore për të gjithë të përfshirët
- Forcimi i bashkëpunimit dhe kohezionit social

Oferta e programit

Ndihma mësimore dhe përkrahja në detyra të shtëpisë bëhet me kursin e paraparë nga tetori deri në qershor, një deri në tre herë në javë (në varësi të nevojës) për 2 njësi (50 minuta secila), kryesisht në institucionet arsimore dhe organizatat e emigrantëve në të gjithë Austrinë e Epërme.

Qëllimi është të punohet sa më individualisht sipas nevojave të nxënësve. Baza për këtë është mësimi social, komunikues dhe ndërkulturor me ndihmë edhe nga njëri-tjetri.